

Fjala e plotë e Zv. Kryeministrit dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës z. Edmond Haxhinasto në Konferencën Ministeriale të Komitetit të Investimeve të Evropës Juglindore (SEEIC) “Europa Juglindore 2020 – Drejt Konvergjencës dhe Rritjes”

Të nderuar Ministra,

Shkëlqesi,

I nderuar ambasador Sequi,

Të nderuar të ftuar,

Kam kënaqësinë që, në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, t’ju uroj mirëseardhjen në Konferencën Ministeriale të Komitetit të Investimeve të Evropës Juglindore.

Të dashur miq,

Gjatë këtij viti që Shqipëria ka bashkë-kryesuar Komitetin e Investimeve, së bashku me Këshillin për Bashkëpunimin Rajonal, ne kemi bërë një progres të jashtëzakonshëm në konsolidimin e zhvillimit të përbashkët të rajonit tonë.

Sfidat e kaluara dhe e tashmja janë diskutuar gjerësisht në shumë raste, por ne jemi fokusuar tek e ardhmja.

Perspektiva e qartë se ku do të jetë rajoni ynë në vitet që do të vijnë na ka ndihmuar të krijojmë politikat dhe veprimet tona për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomive dhe shoqërive tona.

Në këtë vizion, ne kemi vendosur të kemi një të ardhme të përbashkët për të ndarë, ne kemi më shumë gjëra të përbashkëta se përçarje, dhe sa më shpejt të

angazhohemi për këtë qëllim, aq më mirë ju shërben shoqërive tona dhe çdo qytetari.

Ne kemi bërë të njohur gjithashtu se përkushtimi për bashkëpunim mes secilit prej nesh në këtë tryezë, në fushën e zhvillimit ekonomik, është mjaft i rëndësishëm.

Integrimi ekonomik dhe bashkëpunimi ynë rajonal do të na ndihmojë të trajtojmë disa nga sfidat e përbashkëta ekonomike dhe sociale por, për atë që kërkon rajoni, ne kemi nevojë për angazhimin e mëtejshëm përtej asaj që është rënë dakord ; një sërë objektivash rajonale që duhet të arrihen brenda pesë shtyllave për Strategjinë 2020 të EJL: Integrimi, zgjuarsia, rritja gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, brenda një kornize të qeverisjes së mirë.

Synimet kryesore, të formuluar për fushat prioritare, të kenë si objektiv përfundimtar që të gjithë anëtarët e SEEIC të jenë më konkurrues dhe t'i afrojnë më pranë anëtarësimin në BE.

Së bashku me qëllimet e përbashkëta rajonale, ne presim të miratojmë sot Deklaratën e Komitetit të Investimeve për Konferencën Ministrore të Evropës Juglindore, duke integruar në këtë mënyrë objektivat e propozuara rajonale në një dokument koherent dhe ambicioz për të udhëhequr zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e strategjisë EJL 2020.

Në lidhje me zhvillimin e strategjisë EJL 2020, unë do të doja të theksoj se kjo përpjekje paraqet një grup të gjerë të aktiviteteve. Ky është një proces i përhershëm që kërkon jo vetëm angazhimin politik të qeverive, por edhe sinergji dhe angazhim të nivelit të lartë, të një numri të madh të pjesëmarrësve, duke filluar nga administratat e qeverive, partnerë të institucioneve rajonale, partnerë akademik, si dhe mbështetjen e rëndësishme të Komisionit Evropian.

Arritja e ekuilibrit midis ambicies rajonale dhe realizmit kombëtar nuk ishte një detyrë e lehtë. Punë e vështirë me muaj të tërë dhe përpjekjet e përbashkëta me të gjithë kolegët tanë që janë duke qëndruar sot para jush, për të shërbyer në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të rajonit tonë.

Këto përpjekje nuk do të përfundojnë me miratimin e objektivave të deklaratës së sotme, pasi ajo do të prodhojë sukses vetëm nëse kemi një angazhim të të gjithë anëtarëve tanë.

Niveli i lartë i angazhimit parashikon lehtësimin e aktiviteteve të mëtejshme në zhvillimin e një strategjie të detajuar të EJK 2020, bazuar në objektivat e miratuara sot, deri në fund të vitit të ardhshëm.

Ekipi ynë Europa Juglindore 2020 do të punojë në zhvillimin e mëtejshëm të treguesve, masave dhe Planit të Veprimit të Strategjisë EJK 2020, si instrument monitorimi që do të vendoset për të matur progresin e realizimit të objektivave të përcaktuara, si dhe të ndjekin më tej aktivitetet për të përmbushur objektivat strategjike.

Kjo punë e gjerë do të finalizohet në tetor 2013, me qëllim përgatitjen e një strategjie të përcaktuar nga EJK 2020 dhe që do të miratohet në nëntor të vitit të ardhshëm.

Përveç vendosjes së mënyrës së mendimit strategjike rajonale dhe veprimit Startegjia EJK 2020 do të hapë gjithashtu mundësi për iniciativa rajonale që lidhen më ngushtë me veprimet në vazhdim e sipër të Bashkimit European.

Ne do të donim të shihnim gjithashtu që Strategjia EJK 2020 të sigurojë një platformë për donatorët, për të identifikuar fushat e interes të përbashkët, në

mënyrë që ata të mund t'i bashkohen iniciativave të zhvillimit ekonomik, por edhe të përfitojnë nga njohuritë e iniciativave rajonale, organizimeve dhe strukturave.

Të nderuar kolegë,

Ju lutem më lejoni të ndaj me ju disa nga zhvillimet me të fundit të Shqipërisë. Si në Bashkimin Europian apo në rajon, struktura e ekonomisë së Shqipërisë është e dominuar tërësisht nga Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SME). Ashtu si dhe në Bashkimin Europian, 99 për qind e numrit total të ndërmarrjeve në Shqipëri janë SME. Ato kontribuojnë me 80 për qind të GDP dhe punësimit në vend. Shumë reforma ligjore dhe institucionle janë ndërmarrë në 5 vitet e fundit, të cilat kanë çuar në përmirësime të rëndësishme të klimës së biznesit.

Reformat në fushën e regjistrimit të biznesit, lejeve dhe licencave, vlerësimi i ndikimit rregullator, RIA, e-government, avancimin ICT, etj, kanë sjellë rezultate të prekshme në përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Shqipëria ka bërë progres në raportin e fundit Doing Bussines dhe është përmirësuar me 10 vende në Raportin e Konkurrueshmërisë, krahasuar me vitin 2010. Aktualisht Shqipëria është në stadin 2 të zhvillimit dhe kjo quhet një ekonomi “efikase”.

Shqipëria ishte vendi i vetëm që pati rritje të Investimeve të Huaja Direkte gjatë vitit 2010, vit gjatë të cilit ato arritën në 1 miliardë dollarë.

Shqipëria ka përqafuar të gjitha principet e Small Business Act-SBA, që është një prej marrëveshjeve më të rëndësishme të axhendës së Komisionit Europian për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ne takohemi këtu me një propozim konkret, ende shumë punë mbetet për tu bërë. Ne kemi përzgjedhur dhe do të miratojmë sot objektivat më të rëndësishme për rajonin tonë. Gjithsesi, një detyrë sfiduese është ende përpara nesh në përcaktimin e strukturave të duhura qeverisëse dhe programeve të nevojshme që duhen për të arritur këto objektiva deri në vitin 2020. Prandaj, puna jonë nuk do të mbarojë sot; sot ne do të angazhohemi për përgjegjësi të madhe në angazhimin e mëtejshëm dhe iniciativat e tjera për implementimin dhe zhvillimin e Strategjisë së mëtejshme, dhe unë jam i bindur se ne do të vazhdojmë të punojmë në mënyrë të suksesshme, të gjithë së bashku, në arritjen e detyrimeve tona.

Më lejoni të shpreh bindjen time se Objektivat e Strategjisë EJK 2020 që ne miratojmë sot do të na çojnë në drejtimin e duhur. Ne parashikojmë që përpjekjet tona drejt zhvillimit, në mënyrë efektive do të adresojnë prioritetet e zhvillimit ekonomik të rajonit, me objektivin përfundimtar që vendet e rajonit tonë të bëhen më konkurruese, ndërsa ato afrohen më pranë anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Përfitoj nga rasti për të shprehur mirënjohje liderëve të ekipit ekonomik dhe kolegëve të tyre, përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare dhe europiane, donatorëve dhe komunitetit të biznesit, që janë të pranishëm sot dhe jam duke parashikuar mbështetjen dhe kontributin e tyre në punën e SEEIC, për të qenë e një rëndësie të madhe në zhvillimin e mëtejshëm të rajonit.

Ne kemi qenë të nderuar të bashkë kryesojmë Komitetin e Investimeve gjatë këtij viti, dhe në këtë mënyrë dua të rikonfirmoj pjesëmarrjen aktive dhe mbështetjen e Shqipërisë në përpjekjet e mëtejshme të Komitetit të Investimeve dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal.

Ne po lëmë një trashëgimi të rëndësishme për bashkëkryesuesin e rradhës të Komitetit të Investimeve (Bosnja dhe Hercegovina), ndërsa detyra sfiduese pritët të përmbushen gjatë vitit të ardhshëm, dhe ne jemi të sigurt që do ta kryejmë në mënyrë të suksesshme dhe së bashku këtë punë në të ardhmen. Ju uroj juve, të nderuar kolegë, çdo sukses.

I uroj suksese këtij takimi dhe faleminderit për vëmendjen tuaj.